

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**

**FAKULTETI JURIDIK**

**PROGRAMI CIVIL DHE PRONËSOR**



**PUNIM MASTERI**

**KONTRATA PËR SHITJEN E SENDEVE TË LUAJTSHME: ANALIZË KRAHASUESE  
ME TË DREJTEN GJERMANE, AUSTRIAKE DHE FRANCEZE**

**MENTORI:**

**Prof. Ass. Dr. Bashkim Preteni**

**KANDIDATE:**

**Edona Selimi**

**Prishtinë, 2024**

## ABSTRAKT

Ky studim trajton kontratën e shitjes për sende të luajtshme: Analizë krahasuesë me të drejtën Gjermane, Austriake dhe Franceze, duke e analizuar nga dy perspektiva kryesore: historike dhe juridike, por me focus më të veçantë në lidhje me legjislacionin pozitiv të këtyre sistemeve juridike, për të shtjelluar kontratën sipas legjislacionit të tyre dhe për të nxjerr në pah aspektin krahasimor mes këtyre sistemeve juridike në lidhje me kontratën e shitjes për sendet e luajtshme.

Nga aspekti historik, është trajtuar origjina e kontratës së shitje, duke filluar me bazat historike dhe juridike të së drejtës romake, ku u vendosën themelet e konceptit të kontratës së shitjes. Se si ka qenë e rregulluar kjo kontratë, pastaj se si është duke ndjekur zhvillimin e saj në të drejtën shqiptare dhe jugosllave. Në vijim, është analizuar roli dhe ndikimi i së drejtës evropiane, me fokus të veçantë në instrumentet moderne si **Draft Common Frame of Reference (DCFR)** dhe **Principles of European Contract Law (PECL)**, të cilat formësojnë standardet bashkëkohore në këtë fushë dhe duke u fokusuar në rëndësinë e DCFR dhe PECL, në promovimin e harmonizimit dhe unifikimit të së drejtës kontraktore në Evropë, duke ofruar udhëzime për hartimin e legjislacionit kombëtar dhe për lehtësimin e tregtisë ndërkufitare brenda Bashkimit Evropian.

Nga aspekti juridik, studimi përqendrohet në analizën e konceptit të kontratës së shitjes së sendeve të luajtshme, efekteve të saj, të drejtave dhe detyrimeve të palëve kontraktuese (shitësi dhe blerësi), pavlefshmërinë dhe shkeljen e kontratës. Një theks i veçantë i është kushtuar krahasimit të dispozitave ligjore të Kosovës me ato të Gjermanisë, Austrisë dhe Francës, duke identifikuar ngjashmëritë dhe dallimet kryesore midis këtyre sistemeve juridike.

Ky studim ofron një analizë gjithëpërfshirëse dhe krahasimore, duke synuar të nxjerrë në pah zhvillimin historik dhe bazën ligjore të kontratës së shitjes, si dhe rëndësinë e harmonizimit të standardeve ligjore në një kontekst ndërkombëtar dhe evropian. Është analizuar me kujdes legjislacioni i këtyre katër shteteve në lidhje me kontratën e shitjes për sende të luajtshme, dhe gjithmonë duke u munduar që të zbatohet metodologjia krahasimore, për të kuptuar ngjashmëritë dhe dallimet mes këtyre vendeve.

Në fund, është bërë një analizë e **CISG-së**, Kontrata Ndërkombëtare për Shitjen e Mallrave, duke theksuar rëndësinë e saj si një instrument ndërkombëtar për standardizimin e kontratave të shitjes.

Janë trajtuar efektet e detyrimeve, të drejtat dhe përgjegjësitë e palëve, pavlefshmëria dhe shkelja e kontratës në kontekstin e CISG-së. Studimi konfirmon rolin kyç të CISG-së në nxitjen e sigurisë juridike dhe në lehtësimin e tregtisë ndërkombëtare, duke ndikuar thelbësisht në zbatimin dhe interpretimin e kontratave të shitjes.

Përmes një qasjeje analitike dhe krahasimore, ky mundëson të kuptuarit e bazave juridike dhe historike të kontratës së shitjes dhe harmonizimit të saj në nivel ndërkombëtar.

*Fjalët kyçe: Kontrata e shitjes, kontratat evropiane, përmbushja, vlefshmëria, dhe CISG*